REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 910/20
Datë/Datum. 09.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Shëndetësisë

Nr i Prokurimit	**206-20-3664-115**
Nr i brendshëm	**206-20-38-115**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim Emergjent me material laboratorik për testim për SARS-COV-2 "**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Liri-Med
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Agim Ramadani nr.80
(Adresa)

Prishtinë ***10000***
(Vendi) ***(Kodi postar)***

044-197571
(Numri Telefonit) ***(Numri i Faks-it)***

Lirim Mustafa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Tenders.lirimed@gmail.com
(Adresa elektronike)

09.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) ***(Nënshkrimi dhe vula)***

Sh.P.K. "Liri-Med" Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 21.07.2020 Data e hapjes së ofertave: 24.07.2020 Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit:22.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:23.10.2020 Vendimi për kërkesën për rishqyrtim me dt:29.10.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 67 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 44.5 i RROUPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me datë: 22.10.2020 në platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Fillimisht ju sqarojmë se ne në këtë aktivitet të prokurimit me dt.13.08.2020 kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar, . Pas pranimit të letrës standarde ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP, ndërsa pas ankesës tonë OSHP-ja me dt.09.10.2020 ka nxjerr vendimin nr.622,627/20, me të cilin vendim është aprovuar si pjesërisht e bazuar ankesa jonë,

ndërsa është anuluar njoftimi për dhënie dhe është anuluar në tërësi ky aktivitet i prokurimit.

Vendimi i OSHP-së nuk është i qartë sepse paneli shqyrtues e ka marrë këtë vendim duke mos u bazuar fare në faktet e prezantuara nga ne dhe gjithashtu nuk janë shqyrtuar në detaje pretendimet tona ankimore dhe dëshmitë e prezantuara me të cilat dëshmi konfirmohet përgjegjshmëria jonë. Ndërsa konstatimet e OSHP-së në lidhje me papërgjegjshmërinë tonë nuk qëndrojnë fare pasi që ne i kemi ofruar sqarimet e qarta se ne i përmbushim kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo OSHP-ja vetëm është bazuar në nenin 39 të RRUOPP-së, duke mos dhënë asnjë sqarim tjetër në lidhje me pretendimin tonë. Ne kemi kërkuar rivlerësim, pasi qe kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme,ndërsa nuk kemi kërkuar anulim në ankesen tone. Kërkojmë nga OSHP të shqyrtohen pretendimet tona dhe te nxirret vendim meritor në bazë të fakteve , argumenteve dhe kërkesës tonë.

Në lidhje me arsyen tonë të eliminimit nga ana e AK-së ju sqarojmë edhe një herë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe se eliminimi ynë nga ky aktivitet i prokurimit është i pa bazuar për faktin se nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me katalogjet e ofruara nga ne, ka pasur mundësi që në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkojnë sqarime shtesë nga kompania jonë apo eventualisht edhe nga prodhuesit, pasi që ne i posedojmë autorizimet të cilat edhe i kemi prezantuar në ofertën tonë, mirëpo që ne jemi diskriminuar nga ana e AK-së pasi që nuk janë kërkuar sqarime shtesë fare. Te bashkangjitur gjeni edhe katalogun nga prodhuesi Singuway per kete tender ku mund te shihet se jemi plotesisht ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit dhe specifikimet teknike.

Ndërsa referimi i AK-së tek neni 39.8 i RRUOPP-së nuk përkon fare me realitetin e dosjes së tenderit të dorëzuar nga ne, pasi që dosje të tenderit nuk është kërkuar që specifikimet teknike të ofrohen veçantë katalogeve, madje nuk është cekur decidivisht që katalogjet duhet të përmbajnë specifikime teknike por është cekur vetëm për broshurat. Dispozita e nenit 59.2 të LPP-së e thotë qartë që sqarim mund të kërkohen mbi cilindo aspekt të tenderit dhe ligji është akt me i lartë ligjor se sa aktet tjera nënligjore e leje më se sa RRUOPP, prandaj në këtë rast eventualisht ka mundur të shfrytëzohet neni 59.2 i LPP-së, sidomos kur kemi parasysh faktin se ne jemi ofertues më i lirë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës, në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne me dt. 29.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues, e ka cekur se nuk mundet ta shqyrtojë kërkesën tonë për rishqyrtim pasi që me vendim të OSHP-së është anuluar ky aktivitet i prokurimit.

Ky arsyetim i AK-së për mos shqyrtimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe me këtë veprim të saj AK-ja nuk e ka respektuar nenin 108/A. Pasi që nuk është e ndaluar me asnjë dispozitë ligjore të bëhet ankesë kundër një vendimi që po na dëmton neve si kompani e përgjegjshme. Pra AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 108/A, duke mos e shqyrtuar kërkesën tonë për rishqyrtim, pasi që kërkesa për rishqyrtim dhe tani ankesa janë parashtruar më pretendimet plotësisht të bazuara, sepse oferta jonë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit nuk është vlerësuar siç duhet nga ana e autoritetit kontraktues.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet që i kemi cekur më lartë, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sepse asnjëra nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur, për shkak se ne jemi ofertues i përgjegjshëm.

Gjithashtu ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk i ka

plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, pasi që nuk i ka ofruar autorizimet e prodhuesit, mirëpo i ka ofruar nga distributori i tij, andaj shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **OE "Liri-Med"** si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*